

FJALA E DEPUTETIT SALI BERISHA

E ENJTE 30 QERSHOR 2022

Zonja deputete,

Zotërinj deputetë,

Të dashura qytetare dhe qytetarë, që ndiqni këtë seancë,

Zonja drejtuese e Kuvendit,

Ky dekret do të hyjë në analet e këtij parlamenti si dekreti më i turpshëm në historinë e tij, si dekreti, i cili, në një kohë të vështirë, në kohë dhimbjesh, skamjeje, mospasjeje, por edhe urie, në vend që të kthejë sytë nga qytetarët dhe njerëzit në nevojë, vjen këtu me qëllimin e vetëm, që qeveritarët dhe oligarkët të ndajnë përsëri fonde dhe të vjedhin bashkërisht fonde të tjera. Më vjen keq që po e përdor këtë shembull, por kjo të kujton Tanardiet që vidhnin në Vaterlo ushtarët e plagosur dhe të vvarë. Si mund të vidhni sot qytetarët, në një kohë kur vezën, djathin, qumështin e foshnjës e paguajnë më shtrenjtë se gjermani, se francezi, se italiani për shkak të politikave tuaja çnjerëzore. Pse them unë që kjo është një vjedhje e hapur?

Zonja dhe zotërinj,

Të dashur qytetarë dhe qytetare,

Prej shumë kohësh tenderët fitohen gjithnjë me 99,9 % të fondit limit. Kam kohë që e hetoj dhe më rezulton se 99,9 % e fondit limit, që nuk ndodhte kurrë më parë, janë paratë që fituesi i tenderit duhet t'i paguajë zyrtarit dhe qeveritarit. Do të ta jap me 99,9% tenderin, por do të më japësh 30% të kësaj shume. A e dini që vetëm kohët e fundit janë 330 milionë tenderime me 99,9%? A e dini ju që ndërtuesi i vilës në Pajë, i brendit të Milva Ekonomit, Edi Ramës, e fitoi tenderin me 13 milionë euro, me 99,9%, një Sako Sako, që është vëllai i komandantit të Gardës, për mirëmbajtjen e rrugëve të Korçës?

Mirë thua ti, ai është tamam brendi i hajdutit. Pallati pa asnjë faturë, as bankare, as tatimore, as ndërtimore, të çfarëdo lloji, na mbiu në shesh të pallateve dhe tani ndërtuesi shpërblehet. E ka ndërtuar firma e Artan Sakos, vëllai i komandantit të Gardës, dhe shpërblehet me 99,9% tender. Nuk është vetëm ky. Po Salillari, që nuk di ku t'i çojë paratë? Edhe ai me 99,9% e ka fituar tenderin për mirëmbajtjen e rrugëve të Jugut, paçka se shembi rrugën e Borshit, paçka se rruga Berat-Çorovodë, e ndërtuar prej tij, është copë-copë. Nuk ka rëndësi, sepse me 99,9% i ndani paratë. Po si mund ta sillni ju këtë dekret këtu? Pastaj mërzhiteni ju, mos të na thotë Dulja 'spostolisti'! Stoli është fjalë mirë shumë, në radhë të parë.

Do t'ju kujtoj një gjë, se unë kam respekt për ju, jeni zonja, por mos harroni: nuk duhet t'ju keqpërdorë në asnjë mënyrë Edi Rama për imazhin e tij, se edhe Gedafi mbante 12 badigardë, por Gedafi, Gedaf mbetej. Edhe Rama hajdut është e hajdut mbetet. Jo 14 gra, por 36 të marrë e t'i vendosë ministre, përsëri ai është po kaq. Nuk e shpërlani dot ju atë. Përkundrazi, përdor firmat tuaja. Si mund të shpjegohet kjo? Nuk sjell dekret për ata që nuk kanë me çfarë të blejnë qumështin, nuk sjell dekret për pensionistët, që nuk kanë lekë për të blerë ilaçe, nuk sjell dekret për fermerin, i cili po falimenton çdo ditë e më shumë. A e dini se që nga viti 2018 deri më sot lopët, të imtat, dhitë, derrat janë pakësuar me 770 mijë krerë, sipas statistikave?

Rri tani, mos i del zot, sepse ai po ju përpin edhe ju me vjedhjet e tij! Po ju përfshin. Rri, mos i dilni zot atij! Ju thashë: mos harroni, edhe Gedafi vetë vendoste 12 badigardë, por Gedafi, Gedaf mbetet, nuk e përmirësonte dot imazhin ai. Duhet t'i dini mirë gjërat! Si mund të sillni ju një dekret të tillë këtu, kur pas këtij do të sillni ligjin "Për taksat e biznesit të vogël dhe profesionet e lira"? Ju bëj thirrje qytetarëve shqiptarë që të dalin të gjithë në protestë për të ndaluar revanshin e vjedhjes së këtij grupi, që nuk ka as ligj, as moral, që vjedh natën, ditën, vjedh në çdo stinë, në çdo kohë, në errësirë e dritë. Nuk ka të ndalur. Si ka mundësi kjo? Si mund ta bini ju dekretin këtu? Pse nuk sillni një dekret për ata që janë në ndihmë ekonomike?

Pse nuk një sillni dekret për pensionistët, pse nuk sillni një dekret për të sëmurët? E morët vesh që drejtoresha e përgjithshme e spitalit, kunata tamam e ministrit të Rendit, na porosit 710 mijë euro mobilime zyrash, mes të tjerash, që nuk kisha dëgjuar kurrë, edhe shtrat dopio. Më thoni mua, çfarë ju duhet shtrati dopio? Dhomë gjumi është zyra? Çfarë është kjo që bëni? Si ka

mundësi që dilni këtu? A mendoni për këta qytetarë? A vini ju nga zonat bujqësore të vendit? Hajde, se po i lëmë ato të tjerat, por po marr Korçën, Myzeqenë, Elbasanin, Shkodrën, Nënshkodrën. A e kuptoni ju se çfarë po bëhet me fermerin shqiptar sot? Kosova jep 410 euro për hektar, Shqipëria jep 2 euro për hektar?

A e kuptoni se po i shkatërrojnë fermerët me pikat e grumbullimit? Pse po i shkatërrojnë? Jua them unë: se ata nuk kanë para për t'u mbushur valixhet me euro këtyre, kurse pikat e grumbullimit ua mbushin valixhet me euro dhe fermerët i vjedhin gjithë ditën, i rrëmbejnë. Për ata nuk paska rritje çmimesh, nuk rriten fertilizantët, për ata nuk u rrit krahu i punës, nafta; u rritka vetëm për grumbulluesit. Grumbulluesit ju paguajnë juve dhe ju toleroni çmimet. Së fundi, ky Gentian Sharra aty ka deklaruar këtu se Sali Berisha ka tokë në Tiranë, tokë në Dhërmi, tokë në Lalëz. Tani, unë i informoj shqiptarët se ai do të ketë 6 padi: 3 civile, 3 penale dhe e garantoj se shumë shpejt do të dalë edhe ai në kërkim, si Gentian Sharra i tij.